



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS MALISHEVË

Numri i lëndës: 2022:220622

Datë: 10.10.2024

Numri i dokumentit: 06279441

P.nr.157/2022

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË/ DEGA NË MALISHEVË, DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI PENAL, gjyqtari i vetëm gjykues Njazi Morina, me zyrtaren ligjore Alberitë Bibaj, në lëndën penale kundër të akuzuarit X.T.Gnga fshati P., Komuna e Klinës, për shkak të veprës penale vjedhje e pyllit nga neni 349 par.1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjakovë me numër PP/II.nr.743/2022 të datës 13.10.2022, në shqyrtimin fillestar të mbajtur më 15.07.2024, në prezencën e prokurorit të shtetit Shqiponja Jupa, të akuzuarit X.G., **më 18 korrik 2024, nxjerri dhe publikisht shpalli këtë:**

A K T G J Y K I M

I akuzuari **X.G.** i lindur më 15.02.1981 nga fshati P., Komuna e Klinës, nga i ati T. dhe e ëma Z., e gjinisë S., i martuar, i ati i tre fëmijëve, ka të kryer shkollë fillore, i gjendjes së dobët ekonomike, veteran i luftës, i dënuar më parë, me numër personal, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

SEPSE,

Më 30.01.2022 rreth orës 15:00/h, në Rajonin Ekonomiko Pyjor "D." në M., saktësisht në vendin e quajtur "L. R.", me qëllim të përvetësimit të pasurisë në mënyrë të kundërligjshme, i pandehuri X.G. me sharrë motorike ka prerë 296 copë dru të llojit "Qarr", me diametër mesatar 6cm, me gjatësi 3m, e me vëllim të përgjithshëm prej 2.37

m³. me ç' rast Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural - Njësisë Pyjore në M. i ka shkaktuar dëm në vlerë prej 379.20 €uro.

- me çka ka kryer veprën penale vjedhje e pyllit nga neni 349 par.1 të KPRK-së.

Gjykata në bazë të nenit 3,4,7,17,38,39,43,69,70,349 par.1 të KPRK-së, dhe neneve 241,242,364,365 të KPP-së, të akuzuarit **X.G.** i shqipton:

DËNIM ME GJOBË

Të akuzuarin **X.G.** e dënon me dënim me gjobë në shumën prej **KATËRQIND (400) EURO**, të cilin dënim është i detyruar ta paguaj në dy (2) këste në afatin prej dy (2) muajve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimit dhe atë këstin e parë në shumën prej dyqind (200) euro, do të paguhet deri më datën 05, të muajit të parë pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit, dhe këstin e dytë në shumën prej dyqind (200) euro, do të paguhet deri më datën 05, të muajit të dytë pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Nëse personi i dënuar nuk dëshiron ose nuk mund të paguaj gjobën, gjykata në bazë të nenit 43 paragrafi 3 të KPRK-së, dënimin me gjobë do ta zëvendësoj me dënim burgimi në kohëzgjatje prej **njëzet (20) ditësh**, duke llogaritur për çdo ditë të qëndrimit në burgim, nga njëzet (20) euro.

Detyrohet i akuzuari që në emër të kompensimit të viktimave të krimit ti paguaj shpenzimet në shumën prej 20,00 €, si dhe shpenzimet e paushallit gjyqësor në shumën prej 20,00 €, në afatin prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

E dëmtuara Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural – Njësia Pyjore në M., për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

Arsyetimi

Prokuroria Themelore në Gjakovë, në këtë gjykatë ka paraqitur aktakuzë PP/II.nr. 743/2022, të datës 13.10.2022, kundër të akuzuarit X.T.Gnga fshati P., Komuna e Klinës, për shkak të veprës penale vjedhje e pyllit nga neni 349 par.1 të KPRK-së.

Gjykata ka caktuar dhe ka mbajtur shqyrtimin fillestar më 15.07.2024. Pas leximit të aktakuzës nga Prokurori i Shtetit Shqiptar Jupa. Të pandehurit iu dha mundësia për ta pranuar fajësinë apo të deklarohet i pafajshëm.

Pas deklarimit të akuzuarit se ndjehet fajtor për kryerjen e veprave penale për të cilat akuzohet nga Prokuroria, gjykata me Aktvendim pranoi pranimin e fajësisë nga i akuzuari pasi që është bindur plotësisht se ishte i vetëdijshëm për pasojat e pranimin të fajësisë.

Prokurori i shtetit Shqiptar Jupa deklaron se : nuk e kundërshtojë pranimin e fajësisë e bërë nga ane e të pandehurit duke konsideruar se janë plotësuar kushtet ligjore nga neni 242 i KPP-së, i pandehuri ka kuptuar pasojat dhe benefiet e pranimin të fajësisë, po ashtu ky pranim i fajësisë gjend mbështetje në provat materiale dhe personale që përmban aktakuza, aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë apo gabim faktike, andaj meqenëse janë plotësuar kushtet ligjore për pranimin e fajësisë gjykatës i propozojë që të merr aktvendim me të cilin e pranon fajësinë nga ana e të pandehurit për shaka të veprës penale me të cilin ngarkohet, të njëjtin ta shpall fajtor të dënoj sipas ligjit dhe të obligoj në pagesën e shpenzimeve procedurale. Me rastin e caktimit të llojit të dënimit gjegjësisht individualizimi të dënimit gjykatës i propozojë që si rrethanë lehtësuese të merret pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit gjatë kësaj seance, ndërsa si rrethanë rendues të merret shkalla e lartë e dashjes i cili me sharrë motorike ka prere 296 copa drurë të llojit qarr, me vëllim të përgjithshëm 2.37 m³. Po ashtu gjykatës i propozojë që të verifikojë të kaluarën kriminale të pandehurit, varësisht çka rezulton të merr si rrethanë lehtësuese apo rënduese.

I akuzuari X.G., deklarohet i fajshëm për veprën penale për të cilën ngarkohem, të njëjtin e pranoj në mënyrë vullnetare, kërkojë nga gjykata që t më dënojë sa më pak

pasi që jam i gjendjes së varfër ekonomike, e gjitha familja jetojmë në shumën prej 170 euro si veteran përveç që i mbaj familjen time përkujdesem dhe për fëmijët e vëllait tim pasi që vëllai më ka vdekur nga kanceri.

Po ashtu nga shkresat e lëndës dhe nga provat materiale siç janë: fletëparaqitja e rojtarit të pyllit nr.05 e datës 30.01.2022, foto dokumentacion si dhe shkresat tjera që gjenden në lëndë.

Gjykata me pranimin e fajësisë nga i pandehuri ka vlerësuar se janë përmbushur kushtet ligjore që pranimi i fajësisë të aprovet nga ana e gjykatës. Gjykata ka pranuar deklarimin e pranimit të fajësisë nga i pandehuri dhe vlerëson se ky pranim i fajësisë është i mbështetur edhe në provat që gjenden në shkresat e lëndës, të gjitha këto vërtetojnë në mënyrë bindëse për gjykatën elementet inkriminuese të veprës penale e ku krijohet edhe figura në tërësi e veprës penale që ka kryer i pandehuri, andaj mbi këtë bazë edhe gjykata i ka vlerësuar këto prova dhe deklarimin e pranimit të fajësisë nga i pandehuri e ka pranuar si të tillë.

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarit, gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të dispozitave të nenit 69 dhe 70 të KPRK-së, ashtu që posaçërisht rrethanë lehtësuese ka marr faktin se i pandehuri ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet, të njëjtën e ka pranuar në mënyrë vullnetare, i kërkoi falje të dëmtuarit, i premtonte gjykatës se nuk do të përsëris vepër tjetër penale. Ndërsa sa i përket rrethanave rënduese mori faktin se i akuzuari ka qenë i dënuar edhe më parë dhe atë: **I.** P.nr.275/2021, nga neni 349 par.2 i dënuar me kusht prej një (1) viti brenda një (1) viti, i plotfuqishëm më 28.04.2022; **II.** P.nr.59/2014, nga neni 358 par.1 i dënuar me gjobë në shumën prej treqind (300) euro, i plotfuqishëm më 02.09.2016, të gjitha këto rrethana ndikuan që Gjykata ti zbatoi dispozitat e përgjithshme për zbutjen ose ashpërsimin e dënimit të parapara me nenin 70 të KPRK-së, gjykata ka ardhur në përfundim se i akuzuari ka kryer veprën penale të përshkruar në dispozitiv të këtij aktgjykimit, të akuzuarin e dënon me dënim me gjobë në shumën prej katërqind (400) euro, me bindjen se me këtë dënim do të arrihet efekti dhe qëllimi i dënimit nga neni 38 të KPRK-së, dhe ky dënim i shqiptuar sipas bindjes së gjykatës është në proporcion me veprën penale të kryer dhe rrethanat personale të cilat i posedon i akuzuari.

Vendimi për shpenzimet e procedurës penale dhe paushallit gjyqësor është marr bazuar në nenin 449 par. 1 dhe 2 nën par. 2.1 dhe 2.6 të KPP-së, si dhe bazuar në nenin 36 par. 3 nën par. 3. 1 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit nr.08/L-109.

Vendimi për udhëzimin e palës së dëmtuar në kontest civil, për realizim e kërkesës pasurore juridike, është marrë bazuar në nenin 462 paragrafi 2 të KPP-së.

Nga sa u tha më lart, e në bazë të nenit 364,365 të KPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË/ DEGA NË MALISHEVË

DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI PENAL

P.nr. 157/2022, më 18 korrik 2024

**Zyrtarja Ligjore,
Alberitë BIBAJ**

**Gjyqtari i vetëm gjykues,
Njazi MORINA**

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej tridhjetë (30) ditësh, llogaritur nga dita e pranimi të tij. Ankesa dorëzohet përmes kësaj Gjykate, në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.